

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**

---

**Në çështjen juridike të :****AC-I-22-0424-A0001***Paditës/Ankues***H A**, Prishtinë.**Kundër:***E paditura***Bankkos-Banka Themelore** (në likuidim), Prishtinë, e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Dritan Hoxha”, nr.55, Lakrishtë, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Diellza Hoxha, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-III-21-0258, të datës 7 korrik 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 12 prill 2024, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

1. Ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar.
2. Vërtetohet Aktgjykimi i shkallës së parë të DHPGJS-së, C-III-21-0258 i datës 7 korrik 2022.
3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

**Rrethanat procedurale dhe faktike**

Me datë 25 mars 2015, paditësi kishte paraqitur një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN125-0759 të datës 5 mars 2015, me të cilin vendim kërkesa e paditësit për kompensim nga qiraja në shumë prej 21,600.00 euro për periudhë të papërcaktuar ishte refuzuar si e pavlefshme. Kjo për faktin se Autoriteti i Likuidimit kishte konstatuar se bazuar

në listën me emrat e punëtorëve të Bankkos të përgatitur nga Këshilli i Menaxhimit të Bankës, mjetet e arkëtuara nga qiraja u janë shpërndarë brenda grupit të punëtorëve të cilët kanë qenë në listën e pagave të papaguara nga AKP-ja, ndërsa këta punëtorë nuk kanë qenë në marrëdhënie pune me asnjë institucion apo ndërmarrje tjetër si dhe ata të cilët nuk janë lajmëruar në bankë dhe kanë jetuar në diasporë nuk janë paguar nga këto mjete. Gjithashtu Autoriteti i Likuidimit kishte konsideruar se kërkesa e paditësit ishte parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar.

Në ankesë paditësi kishte theksuar se Marrëveshja për qira e arritur ndërmjet Bankkos si qiradhënës dhe Zyrës Zvicerane Federale për Ndërtim dhe Logjistikë si qiramarrëse është nënshkruar me datë 8 shtator 1999. Në shkurt të vitit 2001 bazuar në kontratën e punës ankuesi ishte rikthyer në punë, në tanimë ish Bankën e Re të Kosovës. Me themelimin e marrëdhënies së punës, i ashtuquajtur i Këshilli i Menaxhimit të ish Bankkos i cili menaxhonte me mjetet e qirasë ankuesin njëanshëm e largoi nga lista e përfituesve të mjeteve nga qiraja.

I pakënaqur me këtë vendim, ankuesi së bashku me një numër tjetër të të pakënaqurve me datë 24 mars 2003 kishin parashtruar një padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë për njohjen e të drejtës në ndarjen e mjeteve nga qiraja (C,nr.2083/03). Pasi që nga dita e rifillimit të punës së paditësit në shkurt 2001 deri në ditë ne parashtrimin të padisë në gjykatë me 24 mars 2004 nuk kanë kaluar 5 vite, andaj edhe kërkesa e ankuesit nuk është e parashkruar. Andaj, i kishte propozuar gjykatës që të aprovohet si e drejtë dhe e bazuar ankesa e ankuesit për kompensim nga qiraja në shumën prej 21,600.00 euro nga N.SH Banka Themelore në Prishtinë.

Ankesës i kishte bashkëngjitur këto prova: vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN125-0759 të datës 5 mars 2015, Raparti Federal Zviceran i Financave, një Marrëveshje e përpiluar nga Banka Komerciale/Bankkos si qiradhënëse dhe Zyra Federale për Ndërtim dhe Logjistikë në Bern si qiramarrëse e datës 1 gusht 1999 deri më 31 gusht 2004, një padi e paraqitur në Gjykatën Komunale në Prishtinë e datës 24 nëntor 2003.

Me datë 25 gusht 2016, AKP-ja kishte paraqitur mbrojtjen e saj në të cilën kishte theksuar se kërkesa e paditësit ishte refuzuar për faktin se në kohën e shpërndarjes së mjeteve të arkëtuara nga qiraja këto mjete u janë shpërndarë punëtorëve të cilët kanë qenë në listën e pagave të papaguara nga AKP, e këta punëtorë nuk kanë qenë në marrëdhënie pune në asnjë institucion

apo ndërmarrje tjetër. Ndërsa punëtorët e punësuar në ndonjë institucion apo ndërmarrje tjetër si dhe ata të cilët nuk janë lajmëruar në bankë dhe kanë jetuar jashtë shtetit nuk janë paguar nga këto mjete. AKP kishte konsideruar se një kërkesë monetare e çfarëdo lloji që një punëtor mund të ketë ndaj një punëdhënësi dhe që ka burimin nga marrëdhënia kontraktuale në mes dy palëve duhet të jetë paraqitur në gjyq apo ndonjë autoritet kompetent brenda tre vjetëve nga momenti kur N.SH supozohet të mos ketë përmbushur detyrimet e saj monetare ndaj parashtruesit (pra nga viti 2003 kur nuk është ndërmarrë asnjë veprim tjetër ligjor). Andaj, AKP-ja i kishte propozuar gjykatës që të hudhet poshtë si e palejueshme kërkesëpadija e paditësit ose të refuzohet si e pabazuar. Si provë e kishte bashkëngjitur njoftimin për të gjithë kreditorët dhe pronarët e ndërmarrjes për likuidimin e ndërmarrjes në fjalë.

Me datë 15 shtator 2020, shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-III-15-0165 kishte refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit duke vërtetuar kështu vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit. Gjykata kishte arsyetuar se gjykata me provën padi C.nr.2083/03 ka vërtetuar faktin se paditësi kishte ushtruar padi kundër të paditurit për njohjen e të drejtës së pjesëmarrjes për ndarje nga qiraja mirëpo paditësi nuk ka dorëzuar ndonjë provë se në cilën fazë gjendet procedura e rregullt nëse nuk ka përfunduar. Pas vërtetimit të kësaj gjendje faktike gjykata kishte vlerësuar se ankesa e paditësit nuk ka bazë juridike për faktin se në mes të palëve ndërgjyqëse ka fakte kontestuese në lidhje me ligjshmërinë e kërkesës për kompensimin e shumës së kërkuar për shkak se paditësi nuk e ka pasur statusin e punës të rregulluar me të paditurën. Në rastin konkret gjykata kishte vlerësuar se kërkesa e paditësit tani për tani është e pavlefshme dhe jo e rregullt sepse dokumentacioni për kërkesën apo interesin e pretenduar e paraqitur nga kreditori i pretenduar apo bartësi i interesit të pretenduar për dokumente apo dëshmi plotësuese nuk është i mjaftueshëm për t'iu njohur një kërkesë e tillë derisa ka fakte kontestuese në lidhje me statusin e punës për paditësin me N.SH.

Me datë 8 tetor 2020, paditësi kishte paraqitur një ankesë kundër Aktgjykimit C-III-15-0165 të datës 15 shtator 2020, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, duke i propozuar kolegjit të Apelit të DHPGJS-së që të ndryshoj Aktgjykimin e ankimuar dhe të merr Aktgjykim me të cilin do t'i aprovohet paditësit kërkesa për kompensimin nga qiraja në shumë prej 21,600.00 euro ose të njëjtin ta prishë dhe lëndën t'ia kthej në rivendosje dhe rigjykim DHPGJS-së.

Në ankesë theksohet se pas nënshkrimit të kontratës për qira punonjësit e ish Bankës Themelore – Bankkos në Prishtinë në tubimin e punonjësve kishin marrë vendim që mjetet nga qiraja ti marrin dhe shfrytëzojnë punonjësit të cilët në atë kohë nuk janë rikthyer në punë, në Bankën e Re të Kosovës, në ndërkohë e licencuar për operim si dhe ata të cilët nuk kanë arritur të themelojnë marrëdhënie pune në ndonjë institucion tjetër, pra të gjithë punonjësit e ish Bankkos të cilët më pas mund të mbeten pa punë.

Paditësi ishte rikthyer në punë në Bankën e Re të Kosovës nga muaji shkurt i vitit 2001. Nga kthimi i tij në punë Këshilli i Menaxhimit të Bankkos e kishte larguar paditësin nga lista e përfituesve të qirasë. Me datë 30 shtator 2005 paditësi ishte njoftuar nga ana e punëdhënësit se nuk do ti përtërihet kontrata e punës për të cilën arsye nga data 30 shtator 2005 i njëjti kishte mbetur i papunë. Përkundër faktit se paditësi i ishte drejtuar në janar të vitit 2006 Këshillit të Menaxhimit të Bankkos që të futet në regjistrin e përfituesve të mjeteve nga qiraja, e njëjta nuk e kishte futur asnjëherë paditësin në këtë regjistër. Tutje, paditësi kishte theksuar se në ditën kur i njëjti i ishte drejtuar AKP-së, kontrata për qira e nënshkruar me datë 9 shtator 1999 ndërmjet Bankkos dhe Zyrës Zvicerane Federale për Ndërtim dhe Logjistike ka qenë ende aktive dhe në fuqi, andaj edhe kërkesa e paditësit ka qenë e parashtruar brenda afatit. Ankesës i kishte bashkëngjitur: njoftimin nga Banka e Re e Kosovës për paditësin për shkëputjen e kontratës së punës, i datës 30 shtator 2005.

Me datë 19 gusht 2021, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së me Aktvendimin AC-I-20-0408-A0001 kishte aprovuar ankesën e paditësit si të bazuar duke anuluar kështu Aktgjykimin e ankimuar dhe duke dërguar lëndën për rigjykim në shkallë të parë të DHPGJS-së tek gjyqtari përkatës. Në arsyetimin e këtij Aktvendimi Kolegji i Apelit kishte theksuar se sa i përket parashkrimit të kërkesës paditësi ka dëshmuar se kërkesën e kishte parashtruar në Gjykatën Komunale të Prishtinës në mars 2003 dhe se kjo lëndë në vitin 2013 ishte referuar në DHPGJS e cila është në pritje të zgjidhjes në këtë gjykatë dhe evidentohet me numrin C-III-15-1073. Kolegji i Apelit nuk ishte pajtuar as me vlerësimin e AL të AKP-së dhe shkallës së parë se mjetet e arkëtuara nga qiraja u janë shpërndarë grupit të punëtorëve të cilët kanë qenë në listën e pagave të papaguara nga AKP dhe jo punëtorët e punësuar në ndonjë institucion apo ndërmarrje tjetër si dhe ata të cilët nuk janë lajmëruar në bankë dhe kanë jetuar në diasporë. Kolegji i Apelit nuk kishte gjetur në shkresa të lëndës asnjë dëshmi që do të vërtetonte këto konstatime.

Në këtë çështje Kolegji i Apelit vlerëson se është me rëndësi të vërtetohet se kush e ka marrë vendimin për mënyrën e ndarjes së mjeteve nga qiraja, që ky vendim të prezantohet në shkresa të lëndës dhe të qartësohet se mbi çfarë baze ligjore është themeluar dhe ka vepruar Këshilli Menaxhues dhe a ka pasur një autorizim specifik që të vendos për ndarjen e mjeteve nga qiraja për punëtorët e N.SH-së dhe cilat kanë qenë kriteret për përcaktimin e shpërblimit të dhënë. Gjithashtu është me rëndësi të trajtohet fakti se në çfarë bazë është larguar nga lista e përfituesve paditësi sepse nga lidhja e kontratës deri në momentin e punësimit të tij në Kosovën e Re kishin kaluar 2 vite.

Me datë 29 shtator 2021, paditësi e kishte paraqitur një parashtrësë për plotësimin e ankesës dhe kishte dërguar prova sipas urdhrorit të gjykatës të datës 21 shtator 2021. Në parashtrësë paditësi kishte theksuar se kërkesën për kompensimin e qirasë do të bëj përpjekje ta siguroj në ndërkohë dhe t'ia prezantoj gjykatës. Tutje, kishte deklaruar se dëshmi të shkruar se paditësi është kthyer në vendin e punës në vitin 1999 nuk posedon pasi që në vitin 1999 institucionet financiare në Kosovë nuk i është lejuar vazhdimi i veprimtarisë deri në nxjerrjen e ligjit për bankat. Sa i përket kërkesës së gjykatës që paditësi të bëj precizimin e periudhës së kërkesës për pagesën e qirasë, paditësi e kishte njoftuar gjykatën se kërkesa për pagesën e qirasë ka të bëjë me periudhën nga data 1 tetor 2006, datë kjo kur paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës në Bankën e Re të Kosovës, respektivisht paditësit i ka përfunduar e drejta për pagesën e pagës minimale e deri me datën 31 dhjetor 2013

Parashtrësës së lartcekur i kishte bashkëngjitur këto prova: listën e punëtorëve të bankës që u ndahen të ardhurat, një vendim të Sindikatës së punëtorëve të bankës të datës 27 mars 2000, një regjistër të punëtorëve të filialës në Prishtinë të datës 2 korrik 2001 të lëshuar nga Banka e Re e Kosovës, një vendim mbi formimin e këshillit të menaxhimit të datës 15 shkurt 2001, një vendim mbi formimin e këshillit të menaxhimit të datës 4 dhjetor 2000, kontratë e punës ndërmjet BRK dhe H A (paditësit) e datës 1 korrik 2005, një Aktvendim i Bankës së re të Kosovës me nr. 03-01/17 i datës 1 shkurt 2001, aneks i Marrëveshjes mbi qira me numër 52 të datës 1 janar 2005 ndërmjet Bankkos dhe Bankës së Re të Kosovës, një marrëveshje tjetër mbi qira ndërmjet Bankkos dhe BRK e datës 12 janar 2005 me numër 51, Raporti Federal Zvicëran i Financave, një Marrëveshje ndërmjet Bankkos dhe Zyrës Federale për Ndërtim dhe Logjistikë në Bernë, Shtojcë e kontratës garantuese e datës 15 shkurt 2000, një padi e paraqitur në

Gjykatën Komunale në Prishtinë e datës 24 nëntor 2003 së bashku me listën e nënshkruesve të kësaj padie si dhe një autorizim për përfaqësim.

Me datë 28 shtator 2021, AKP-ja kishte paraqitur një përgjigje në urdhrin e gjykatës të datës 21 shtator 2021 në të cilin theksohet se parashtruesi nuk ka arritur me asnjë provë të besueshme dhe relevante të vërtetoj faktin se marrëdhënia e punës i është ndërprerë si pasojë e asaj se ndërmarrja ka hyrë në likuidim. Kësaj përgjigje ia ka bashkëngjitur kërkesën e parashtruesit të paraqitur në AL së bashku me këto prova: formularin për parashtrimin e kërkesës jo pronësore në likuidim, kopjen e letërnjoftimit, kopjen e librezës së punës së paditësit, një vendim me numër 1276/70 të datës 27 dhjetor 1990, kërkesën për inkorporimin e 30% të qirasë mujore në 70% të datës 30 janar 2009, një vendim i Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN125-0759 të datës 3 dhjetor 2014, përgjigje në kërkesën e AKP-së për dokumente dhe informacione shtesë e datës 24 dhjetor 2014, mbrojtja e AKP-së, njoftimi i AKP-së për fillimin e likuidimit të ndërmarrjes, lista përfundimtare e punëtorëve që kanë plotësuar kriteret për përfitimin e një pjese të së hyrave prej 20%,

Me datë 4 tetor 2021, gjykata kishte lëshuar një urdhër për paditësin nga i cili kishte kërkuar që të precizoj kërkesën për periudhën për të cilën e kërkon kompensimin nga cila datë, muaj dhe vit e deri në cilën datë, muaj dhe vit e kërkon kompensimin e shumës prej 21,600.00 euro, sikundër të dorëzoj edhe një dëshmi nga N.SH ose eksperti financiar për llogaritjen e shumës së kërkuar 21,600.00 euro.

Me datë 18 tetor 2021, paditësi ishte përgjigjur në urdhrin e lartcekur të cilit i kishte bashkëngjitur raportin financiar për kompensimin-shpërndarja e qirasë si dhe njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të datës 30 shtator 2005.

Me datë 27 tetor 2021, gjykata kishte lëshuar një urdhër për të paditurën në të cilin kishte kërkuar nga e paditura të jap kundërpërgjigje me shkrim në parashtrësën e paditësit të datës 18 tetor 2021.

Me datë 19 tetor 2021, e paditura kishte paraqitur përgjigje në urdhrin e lartcekur të gjykatës në të cilën kishte theksuar se në momentin që konstaton se kërkesa e parashtruesit është refuzuar për shkak se parashtruesi është vonuar në paraqitjen e saj para ndonjë organi kompetent, atëherë AL-ja mund të mos lëshohet fare në shqyrtim të çështjes sepse instituti i parashkrimit

nuk e lejon një gjë të tillë. Përgjigjes i kishte bashkëngjitur: formularin për parashtrimin e kërkesës jo pronësore në likuidim, kopjen e letërnjoftimit, kopjen e librezës së punës, një Aktvendim nr. 1276/70 të datës 27 dhjetor 1990, një vendim të Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN125-0759 të datës 5 mars 2015.

Me datë 2 qershor 2022, AKP-ja kishte paraqitur një kundërpërgjigje në të cilën i kishte propozuar gjykatës që të refuzoj parashtrësën si të pabazuar dhe të papranueshme dhe të vërtetoj vendimin e Autoritetit të Likuidimit. Kundërpërgjigjes i kishte bashkëngjitur: formularin për parashtrimin e kërkesës jo pronësore në likuidim, kopjen e letërnjoftimit, kopjen e librezës së punës, një Aktvendim nr. 1276/70 të datës 27 dhjetor 1990, një urdhër të gjykatës C-III-21-0258 të lëshuar me datë 4 tetor 2021, një parashtrësë të paditësit për plotësimin e ankesës dhe dërgimin e provave të datës 29 shtator 2021.

Me datë 7 korrik 2022, shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktgjykimi C-III-21-0258 kishte refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit dhe kishte vërtetuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN125-0759 të datës 5 mars 2015. Në arsyetimin e këtij Aktgjykimi theksohet se kontestuese në këtë çështje ka qenë baza juridike e kërkesës së paditësit për të përfituar si rentë apo ndihmë nga Banka Themelore e cila ka realizuar të hyra nga qiraja. Paditësi përkundër urdhrin të gjykatës nuk e kishte precizuar periudhën e saktë të kërkesës së tij për shumën 21,600.00 euro, ndërsa nuk kishte arsyetuar as me ndonjë provë të vlefshme se si është llogaritur kjo shumë e kërkuar. Paditësi kishte dorëzuar një llogaritje të shumës për periudhën e janarit 2006 deri në dhjetor 2013 në shumën prej 16,200.00 euro por që personi që ka llogaritur këtë shumë nuk kishte dhënë asnjë arsyetim me shkrim se në çka e mbështetë këtë llogaritje. Gjykata kishte vlerësuar se vendimi i Sindikatës së Punëtorëve i datës 27 mars 2000 në lidhje me kriteret për ndarje të rentës/ndihmat është vendim mbi bazën e të cilit ka vepruar edhe Këshilli Menaxhues i zgjedhur nga Tubimi i punëtorëve i Bankës Themelore me datë 15 shkurt 2001. Në bazë të listës së punëtorëve të hartuar nga Banka e Re e Kosovës të filialës në Prishtinë këtë regjistër gjendet edhe paditësi si i punësuar në Bankën e Re të Kosovës. Gjykata kishte vlerësuar se në rastin konkret, Vendimi i Sindikatës së punëtorëve të Bankës Themelore në Prishtinë të datës 27 mars 2000 e i cili vendim nuk ka prova se ai është kundërshtuar nga ndonjë punëtor, veçanërisht nga paditësi brenda ndërmarrjes, ndërsa AKM-ja nuk ka prova se një vendim i tillë e ka anuluar pas themelimit të saj si administratore e N.SH-së.

Bazuar në këtë vendim paditësi nuk ka bazë juridike të kërkoj kompensimin si rentë pasi i njëjti kishte të rregulluar marrëdhënien e punës te subjekti tjetër financiar Banka e Re e Kosovës dhe se ndërprerja e kontratës së punës nga subjekti financiar Banka e Re e Kosovës atij nuk i ka dhënë asnjë bazë juridike që ai të kërkoj të vendoset në listën e rentës si përfitues nga renta pavarësisht nga fakti se nuk ka ndonjë vendim formal se atij i është ndërprerë marrëdhënia e punës nga N.SH-ja.

Gjykata kishte vlerësuar se qëllimi i vendimit të sindikatës së punëtorëve ka qenë që punëtorët e mbetur të papunë të përfitojnë nga të hyrat që realizohen nga qiraja sepse Banka Themelore nuk ka ushtruar veprimtarinë e saj. Andaj, në rastin konkret, AKP-ja me rastin e refuzimit të kërkesës së paditësit drejtë ka vepruar pasi që ka konstatuar se paditësi nuk mund të përfitoj rentë për shkak se i njëjti nuk ka plotësuar kriteret sipas vendimit të sindikatës.

Me datë 29 korrik 2022, paditësi kishte paraqitur një ankesë kundër Aktgjykimit C-III-21-0258 të datës 7 korrik 2022, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke i propozuar Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së që Aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të merret Aktgjykim sipas të cilit paditësit t'i aprovohet kërkesa për kompensimin nga qiraja në shumën prej 21,600.00 euro ose Aktgjykimin e ankimuar ta prishë dhe lëndën ta kthej në rigjykim në DHPGJS. Në ankesë paditësi kishte theksuar se DHPGJS me rastin e vendosjes së kësaj çështje në rigjykim nuk i ka përfillur vërejtjet e dhëna nga Kolegji i Apelit të DHPGJS-së sepse vërejtjet e dhëna kryesisht kanë qenë të adresuara lidhur me parashtrimin e kërkesës së paditësit si dhe vlerësimin që ka dhënë AL dhe shkalla e parë se mjetet e arkëtuara nga qiraja u janë shpërndarë grupit të punëtorëve të cilët kanë qenë në listën e pagave të papaguara nga AKP-ja dhe jo punëtorët e punësuar në ndonjë institucion apo ndërmarrje tjetër si dhe ata të cilët nuk janë lajmëruar në bankë dhe kanë jetuar në diasporë. Gjithashtu është dashur të vërtetohet se kush e ka marrë vendimin për mënyrën e ndarjes së mjeteve nga qiraja dhe të qartësohet se mbi cilën bazë ligjore është themeluar dhe ka vepruar Këshilli Menaxhues dhe a ka pasur një autorizim specifik që të vendos edhe për ndarjen e mjeteve nga qiraja.

Në rastin konkret paditësi konsideron se aktgjykimi i ankimuar është i pabazuar sepse mjetet e marra nga qiraja janë mjete që janë marrë në emër të kontributit dhe punës së kaluar të të gjithë punëtorëve të ish Bankës në fjalë andaj si të tilla këto mjete me të drejtë në terminologjinë



juridike njihen si mbledhje të fryteve e jo si rezultat i punës, të cilat mjete është dashur të shpërndahen në formë lineare-proporcionale “kokë për kokë” (për capita) të gjithë punonjësve të ish Bankës Themelore “Bankkos” e asesi në formën dhe mënyrën siç ka bërë i ashtuquajtimi Këshilli Menaxhues i të njëjtës Bankë. Nga provat në shkresa të lëndës shihet qartë dhe rezulton i pakontestueshëm fakti se kërkesa e paditësit nuk është e parashkruar dhe i ka plotësuar të gjitha kushtet ligjore që paditësi të jetë i përfshirë në listën e përfituesve nga Këshilli Menaxhues i kësaj banke. Andaj, duke pasur parasysh këto që u thanë i kishte propozuar Kolegjit të Apelit si më lartë.

Me datë 10 tetor 2022, AKP-ja kishte paraqitur përgjigje në ankesë në të cilën konsideron se argumentet e paraqitura në ankesë janë të përsëritura dhe i propozon Kolegjit të Apelit që të refuzoj ankesën e paditësit si të pabazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar.

### **Arsyetimi i ligjor**

Ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHPGJSK), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

### **Meritat e ankese dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar i gjyqtarit të shkallës së parë të DHPGJS, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se kërkesa e paditësit për kompensimin nga qiraja në shumë prej 21.600,00 € si dhe një tabelë llogaritare në shumë prej 16.200 euro për periudhën sipas parashtrësës për plotësimin e padisë të datës 29 shtator 2021 nga datat 01 tetor 2006 deri më datën 31 dhjetor 2013 është refuzuar si e pavlefshme, me arsyetimin se marrëdhënia e punës së tij ishte ndërpre më 1999 dhe të drejtat e tij nuk “janë pushuar nga puna si rrjedhojë apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga AKP-ja.

Shkallës e parë të DHPGJS-së e kishte refuzuar padinë e paditësit me arsyetim se i njëjti nuk kishte arsyetuar me ndonjë provë të vlefshme se si është llogaritur kjo shumë e kërkuar përkundër urdhrin të leshur për precizimin.

Kolegji i Apelit i DHPGJS-së pas shqyrtimit të shkresave të lëndës kishte vërejtur se paditësi së bashku me ankesën e tij të ushtruar ndaj vendimit PRN125-0759 të datës 15 mars 2015, përveç vendimit të AKP kishte sjellë edhe prova tjera si: ndahen të ardhurat, një vendim të Sindikatës së punëtorëve të bankës të datës 27 mars 2000, një regjistër të punëtorëve të filialës në Prishtinë të datës 2 korrik 2001 të lëshuar nga Banka e Re e Kosovës, një vendim mbi formimin e këshillit të menaxhimit të datës 15 shkurt 2001, një vendim mbi formimin e këshillit të menaxhimit të datës 4 dhjetor 2000, kontratë e punës ndërmjet BRK dhe H A (paditësit) e datës 1 korrik 2005, një Aktvendim i Bankës së re të Kosovës me nr. 03-01/17 i datës 1 shkurt 2001, aneks i Marrëveshjes mbi qira me numër 52 të datës 1 janar 2005 ndërmjet Bankkos dhe Bankës së Re të Kosovës, një marrëveshje tjetër mbi qira ndërmjet Bankkos dhe BRK e datës 12 janar 2005 me numër 51, Raporti Federal Zvicëran i Financave, një Marrëveshje ndërmjet Bankkos dhe Zyrës Federale për Ndërtim dhe Logjistikë në Bernë, Shtojcë e kontratës garantuese e datës 15 shkurt 2000, një padi e paraqitur në Gjykatën Komonale në Prishtinë e datës 24 nëntor 2003 së bashku me listën e nënshkruesve të kësaj padie si dhe një autorizim për përfaqësim.

Kolegji i Apelit konsideron se paditësi me asnjë provë nuk ka arritur të dëshmojë se ishte në marrëdhënie pune në NSH. në periudhën për të cilën i kërkon kompensimin për qira. Sipas Njoftimit nr. 2457 të datës 30 shtator 2005 të njëjtit, po të njëjtën ditë i ishte ndërpre kontrata e punës për arsye, ndryshimet strukturale me që rast vendi i punës se tij ishte shuar. Në bazë të këtij Njoftimi paditësi nga kjo datë nuk ishte punëtor i NSH-së në fjalë andaj edhe pretendimi i tij për kompensimi për qira për periudhën e cekur me lartë nuk është i bazuar .

Padia e parashtruar në Gjykatën Komonale Prishtinë më 24 mars 2003 tani gjendet në DHPGHS me nr. C-III-15-1073 është ende aktive. Edhe nëse paditësi në këtë çështje del i suksesshëm , nuk mund të reflektoj në çështjen për të cilën tani po vendosim për arsye të periudhës kohore të specifikuar nga paditësi dhe Njoftimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës nr. 2457 të datës 30 shtator 2005

Nga faktet e paraqitura si dhe ,nga provat e gjetura në shkresat e lëndës nuk mund të gjendet ndonjë kërkesë apo provë me të cilën mund të vërtetohet se paditësi kishte ankimuar Njoftimin në fjalë para ndonjë organi administrativë apo gjykatë.

Barra e provës sipas nenit 42. 2 të Ligjit për DHPGJS, për të vërtetuar një fakt bie mbi paditësin. Paditësi përkundër provave të lartcekura të cilat ndodhen në shkresa të lëndës, nuk ka vërtetuar faktin se me ndonjë veprim të AKP-së, atij i është ndërprerë marrëdhënia e punës dhe se ishte në marrëdhënie pune për periudhën për të cilën kërkon kompensimin.

Prandaj, Kolegji i Apelit vlerëson se Shkalla e parë e DHPGJS-së ka vepruar drejtë kur ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit, pasi që të njëjtit në mungesë të provave nuk mund t'i njihet e drejta në kompensim bazuar në nenin 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së nr. 04/L-034.

Prandaj nga këto arsye ankesa e paditësit refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si drejtë dhe i bazuar në ligj.

### **Taksat gjyqësore**

Ankuesi tashmë e ka paguar taksën gjyqësore më 19/09/2022 për procedurën ankimore, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 12 prill 2024.

Mr.sc Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues

\_\_\_\_\_